



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3. 2023

Nr: 106

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA E GJELBËR” PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 611 Prot., datë 3.2.2023, me:

**Kërkues:** Partia politike “Partia e Gjelbër”, me Kryetar z. Edlir Petanaj

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia e Gjelbër” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

**V Ë R E J:**

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

“Partia e Gjelbër”, nëpërmjet Kryetarit të saj z. Edlir Petanaj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

Data: 8.3. 2023 Nr: 106  
Ora: 11:00



Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia e Gjelbër”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 10.01.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia e Gjelbër”, me iniciais “PGJ”, me Kryetar z. Edlir Petanaj rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia e Gjelbër” me shkronja nistore “PGJ”, me adresë Rruga “Blv Bajram Curri”, Pall 31, Shk. 1, Ap. 4, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Edlir Petanaj, me adresa, Rruga “Ded Gjon Luli” pall 3, Shk.1 Ap.13, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Andi Hoxha me adresë Rruga “Blv Bajram Curri”, Pall 31, Shk. 1, Ap. 4, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Enzo Muho, me adresë Rruga “Islam Alla” Pallatet “Romario”, Nd 4, Hyrja 2, K10, Ap.53 Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia e Gjelbër”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia e Gjelbër”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64 pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

#### **VENDOSA:**

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia e Gjelbër”, me kryetar z. Edlir Petanaj, me shkronjat nistore “PGJ”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 8.3. 2023 Nr:  
Ora: 11:00



Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike "Partia e Gjelbër", për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.